

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, QË NDRYSHON MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Memorandumi i mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (BE), për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian, është nënshkruar më 28 shtator 2016, me përjashtim të përfshirjes në komponentin e këtij programi që lidhet me luftën kundër lëndëve narkotike.

Pas nënshkrimit të Memorandumit, Komisioni Evropian propozoi amendimin e tij, me qëllim përfshirjen e Shqipërisë dhe në pjesën e katërt të komponentit “Politika e luftës kundër drogave”, të programit të drejtësisë së BE-së.

Ky ndryshim i memorandumit të mirëkuptimit synon shtrirjen e fushëveprimit tematik të tij, duke përfshirë edhe objektivin, që lidhet me iniciativa në fushën e politikës së drogave, konkretisht komponenti “Politika e luftës kundër drogave”, si pjesë e rregullores së BE-së nr.1382/2013 mbi të cilën mbështetet ky Memorandum.

Në veçanti, nëpërmjet këtij ndryshimi, synohet mbështetja e iniciativave në fushën e politikës së drogës mbi bashkëpunimin gjyqësor dhe aspektet e parandalimit të krimit dhe luftën ndaj tij, lidhur ngushtë me objektivin e përgjithshëm të programit të drejtësisë.

Memorandumi është nënshkruar nga palët në datën 12 shkurt 2018.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është planifikuar në programin analitik të projektakteve për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2018, por është në përputhje me programin

politik të qeverisë dhe implementimi i tij do të mundësojë rritjen e efikasitetit të institucioneve ligjzbatuese në luftën kundër lëndëve narkotike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Qëllimi afatgjatë i miratimit të këtij projektakti është ofrimi i asistencës për zbatimin e legjislationit të BE-së në lidhje me: identifikimin dhe vlerësimin e substancave psikoaktive të reja, riintegrimin dhe rehabilitimin e përdoruesve të drogës, duke përfshirë edhe ata që kanë vuajtur dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, zhvillimin e metodologjive të përbashkëta të autoriteteve publike, në nivel lokal apo rajonal, dhe shoqërisë civile, me qëllim uljen e numrit të veprave penale të lidhura me drogën, shtimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit, përfshirjen e shoqërisë civile në zbatimin e objektivave të strategjisë dhe planit të veprimit të BE-së për drogën 2013-2020, me qëllim zvogëlimin e pasojave negative.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe me legjislationin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Shqipëria, e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, ka nënshkruar, më 28 shtator 2016, memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrjen e kësaj të fundit në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian. Ky memorandum është ratifikuar me ligjin nr.11/2017 dhe përfshin 3 komponentë që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që nuk përfshin pjesën e katërt të komponentit që lidhet me politikën e luftës kundër drogave.

Duke qenë se objektivi që lidhet me luftën kundër lëndëve narkotike është pjesë e rregullores së BE-së nr.1382/2013, mbi të cilën mbështetet ky memorandum, nga Ministria e Brendshme, në datën 17.8.2016, me anë të një shkrese drejtuar

Komisionit Evropian, u shpreh interesi për t'u përfshirë edhe në pjesën e katërt të komponentit “Politika e luftës kundër drogave”, të programit të drejtësisë të BE-së.

Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian në Bruksel përcolli për kompetencë projektvendimin e Komisionit Evropian, që amendon memorandumën e mirëkuptimit mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e drejtësisë të BE-së, duke shtuar edhe pjesën e katërt të komponentit “Politika e luftës kundër drogave”, e cila ka si pjesë të saj edhe elementin e kontributit financiar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit) dhe Ministria e Drejtësisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Mbështetur në kuadrin ligjor për sistemin buxhetor, si dhe në procedurat përkatëse buxhetore të miratuara, likuidimi i këtij detyrimi në një faturë të vetme mund të realizohet nëse njëra nga ministritë (Ministria e Drejtësisë apo Ministria e Brendshme) disponon fondet e nevojshme në buxhetin e saj të miratuar për realizimin e pagesës së përcaktuar.

Në rastin kur vlera e faturës duhet të përballohet nga të dyja ministritë, sipas shumave të parashikuara në buxhetet e tyre përkatëse, për realizimin e pagesës nga ana e njëres ministri, është i nevojshëm të bëhet rialokimi i fondit përkatës nga buxheti i njëres ministri në buxhetin e ministrisë tjetër, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas kriterëve dhe procedurave përkatëse.

Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, për të marrë pjesë në bashkëpunimin gjyqësor, trajnimin gjyqësor dhe akses në linjat e programit të drejtësisë do të jetë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2017 parashikohen 41674 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme);

Për vitin 2018 parashikohen 43260 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme);

Për vitin 2019 parashikohen 44974 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme);
Për vitin 2020 parashikohen 46662 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme).

Efektet financiare për pjesën e katërt të komponentit (d) “Politika e luftës kundër drogave”, që do të mbulohen nga Ministria e Brendshme, janë 6000 euro për secilin vit buxhetor dhe do të përballohen nga buxheti i programit “Policia e Shtetit”.

KËSHILLI I MINISTRAVE